LAJME / KRONIKA E ZEZË

# Policia jep detaje për personin që u gjet i vdekur në Deçan

25.12.2019 • 19:57




Vuçiq tregon me emër pjesëtarin e policisë serbe që ka plaçkitur shqiptarët gjatë luftës në Kosovë

Lexo Artikullin

"Ju njoftojmë se me datën 29.12.2019 rreth orës 15:17 Policia ka pranuar informacion se në rrugën 'Luan Haradinaj' në Deçan, një person gjendej i vdekur.

Menjëherë njësitet relevante të Policisë kanë dalë në vendin e ngjarjes, së bashku me Prokurorin e shtetit dhe ekipin mjekësor i cili ka konstatuar vdekjen e viktimës.

Sipas të dhënave nga hetuesit nga vendi i ngjarjes viktima shtetasi Q.B. lindur në vitin 1972, kishte ndërruar jetë nga arma e zjarrit të cilën dyshohet se e ka përdorur për t'i shuar jetën vetës. Arma e gjetur në vendin e ngjarjes për të cilën mendohet se është përdorur nga viktima, është sekuestruar për tu ekzaminuar", thuhet në njoftimin për media.

Me shikimin e vendit të ngjarjes ka udhëhequr prokurori i shtetit dhe me vendim të tij , trupi i pa jetë i viktimës është bartur nga vendi i ngjarjes rreth orës 19:10 për tu dërguar për obduksion në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) Prishtinë .

Rasti do të hetohet nga Njësiti Rajonal i Hetimeve DRP Pejë, në bashkëpunim të plotë me prokurorin e shtetit për tu sqaruar të gjitha rrethanat rreth këtij rasti i cili është duke u hetuar si hetim i vdekjes. /Telegrafi/

Shfaq statistikat COVID-19

Deçan Policia e Kosovës

Vuçiq tregon me emër pjesëtarin e policisë serbe që ka plaçkitur shqiptarët gjatë luftës në Kosovë

Lexo Artikullin